

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Raporti i rremë i IA-së për pak sa nuk nisi luftë mes SHBA-së dhe Kinës, CNN: Operacioni u anulua në momentin e fundit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/pothuajse-nisi-nje-lufte-raporti-i-rreme-i-krijuar-me-ia-shba-gati-te-nderh-i586992
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 05:59:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 05:56:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d9ac616a7c27d37c650fc3a6c23f9cf20e50fabdc719a087e84d826276515a65
TEKSTI	ac9297ef6fb33fcaa9eea5526e8c29dc42a9a7bc7f6223e9d2fa9759759b777a
PAMJA	7d673f65419b60a1fd28f250d0b1049ed46086e2cb05defb310b21fb2ac2ee90

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1cb0ecfa52455186e73331efc5dfecee4fb66ad07a1cec8b4ab31c6a87eff1dd
E MËPARSHMJA	1718319b842c7c9839a03a9b91eb9c06bcc4cece4e7de92b4faa69c4bf77c8e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1cb0ecfa52455186e73331efc5dfecee4fb66ad07a1cec8b4ab31c6a87eff1dd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le [Marreveshje historike per Groenlanden, SHBA zgjeron pranine ushtarake pa ndryshuar sovranitetin danez](#) "The Independent" rekomandon Shqiperine: Pushime mes Rr fundit

Raporti i rremë i IA-së për pak sa nuk nisi luftë mes SHBA-së dhe Kinës, CNN: Operacioni u anulua në momentin e fundit



19 Shtator 2026, 07:56Bota TEMA



Një raport i rremë inteligjence, i përpiluar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale, për pak sa nuk e çoi ushtrinë amerikane drejt një operacioni kundër një anijeje kineze në Lindjen e Mesme. Sipas një raportimi të CNN, incidenti rrezikoi të shkaktonte një krizë të rëndë mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, e cila mund të përshkallëzohej në një konfrontim të drejtpërdrejtë ushtarak. Raporti iu dorëzua ushtrisë amerikane gjatë pranverës, në periudhën kur SHBA-të ishin të përfshira në luftën me Iranin. Në të pretendohesh se një anije kineze që ndodhej në Lindjen e Mesme transportonte komponentë të lidhur me një program për zhvillimin e armëve bërthamore.

Ushtria amerikane reagoi duke hartuar plane për kapjen e anijes. Sipas burimeve të cituara nga CNN, forca të armatosura po përgatiteshin për të hipur në anije, ndërsa avionë ushtarakë amerikanë kishin nisur të ngriheshin në ajër.

Megjithatë, pak para se operacioni të niste, zyrtarët e shqyrtuan më nga afër informacionin dhe zbuluan se raporti ishte përpiluar me ndihmën e një mjeti të Inteligjencës Artificiale, i cili kishte identifikuar gabimisht ngarkesën e anijes. Sipas CNN, ende nuk dihet se çfarë përmbante në të vërtetë ngarkesa që ishte interpretuar gabimisht nga sistemi. Një burim e përshkroi raportin si "plotësisht të rremë", duke theksuar se ai "pothuajse nisi një luftë", pasi një operacion amerikan kundër një anijeje kineze mund të kishte shkaktuar një përshkallëzim serioz ushtarak.

Si u krijua informacioni i rremë

Incidenti ka nxjerrë në pah rreziqet që lidhen me integrimin e shpejtë të Inteligjencës Artificiale në ushtrinë dhe komunitetin amerikan të inteligjencës. Sipas CNN, një analist përdori një chatbot për të përpunuar informacion mbi ngarkesën e anijes, të dhëna që vinin nga Komanda e Operacioneve Speciale të SHBA-së në Paqësor, me bazë në Hawaii. Sistemi bashkoi të dhëna nga burime të hapura me informacion nga inteligjenca e sinjaleve, të klasifikuara dhe të ruajtura në bazat e të dhënave të qeverisë amerikane. Nga kjo përpunim doli një përfundim i gabuar për natyrën e ngarkesës së anijes.

Më pas, analisti përdori sërish Inteligjencën Artificiale për të hartuar një raport formal inteligjence. Raporti iu shpërnda zyrtarëve ushtarakë si një analizë e verifikuar, pavarësisht se përfundimi i tij ishte i pasaktë. Nuk është bërë e qartë nëse chatbot-i ishte një mjet i disponueshëm komercialisht apo një sistem i zhvilluar nga qeveria amerikane. Një ish-zyrtar i lartë amerikan, i njohur me sistemet e IA-së të përdorura nga analistët ushtarakë dhe të inteligjencës, tha se mjetet e brendshme janë në pjesën më të madhe versione të aplikacioneve komerciale, të përshtatura për përdorim institucional.

Pentagoni dhe Komanda e Operacioneve Speciale të SHBA-së në Paqësor nuk kanë komentuar publikisht mbi incidentin. Ushtria amerikane po investon gjithnjë e më shumë në Inteligjencën Artificiale, me synimin për të përshpejtuar vendimmarrjen në fushën e betejës. Teknologjia po synohet të përdoret në fusha që variojnë nga përcaktimi i objektivave deri të menaxhimit të operatave ushtarake, zbulimit të furnizimit dhe kurbetave. Qeveria amerikane argumenton

rusia që varet nga pajisjet e objektivave dhe të monitorimit ushtarak, zharrimave të rrethimit dhe ushtarak. Qeveria amerikane argumenton se SHBA-të nuk mund të lejojnë të mbeten pas në zhvillimin e teknologjive të IA-së, veçanërisht në raport me rivalë si Kina.

Në janar, Sekretari i Mbrojtjes, Pete Hegseth, prezantoi strategjinë e Pentagonit për përshejtimin e përdorimit të Inteligjencës Artificiale. Ai deklaroi se SHBA-të duhet të forcojnë aftësitë e tyre në këtë fushë dhe të reduktojnë pengesat burokratike që mund të ngadalësojnë zhvillimin e teknologjisë. Megjithatë, zyrtarë të njohur me mënyrën se si funksionojnë këto sisteme kanë ngritur shqetësime për mungesën e një kuadri të unifikuar sigurie. Sipas tyre, agjenci të ndryshme përdorin mjete të ndryshme, me rregulla të ndryshme kontrolli dhe nivele të ndryshme besueshmërie. Incidenti me anijen kineze nuk është, sipas burimeve të cituara nga CNN, një rast i izoluar. Të ashtuquajturat “iluzione” të Inteligjencës Artificiale, pra prodhimi i informacionit bindës, por të pasaktë, janë shfaqur edhe në raste të tjera brenda komunitetit amerikan të inteligjencës.

Shqetësim i veçantë lidhet me përdorimin e IA-së në operacionet e shënjestrimit, ku një gabim mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta njerëzore. Një burim i njohur me politikën aktuale ushtarake tha se përdorimi i IA-së në shënjestrim po rritet, ndërsa ende nuk ka udhëzime të qarta se si përfshirja e një njeriu në proces mund të parandalojë viktimat civile apo zjarrin miqësor. Në të njëjtën kohë, disa zyrtarë të lartë të inteligjencës shqetësohen se presioni për të prodhuar analiza më shpejt mund të sjellë më shumë gabime, veçanërisht kur analistët më të rinj u besojnë në mënyrë të tepruar mjeteve të Inteligjencës Artificiale. Një nga burimet e cituara nga CNN e përmbledhi rrezikun me një frazë: “IA ju lejon të arrini në një ide të keqe më shpejt.”

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg! Një provë e re për Merzin pas humbjes së rëndë në Saksoni

07:43 Bota

IA merr në dorë propagandën/ NYT: Si Kina, Irani dhe kompani izraelite po manipulojnë debatin online përmes profileve të rreme

22:50 Bota

Trump paralajmëron vendim për Iranin dhe bisedime me Huthitë: Do të shohim çfarë do të ndodhë

22:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.